



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1392 Prot.

Tiranë, më 07.11 2019

**VENDIM Nr. 229, datë 31.10.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12, datë 31.10.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Infrastruktura Bashkiake IV", për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në qytetin e Delvinës-subjekti "Ujësjellës Kanalizime Delvinë" sh.a*, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Infrastruktura Bashkiake IV", për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në qytetin e Delvinës-subjekti "Ujësjellës Kanalizime Delvinë" sh.a*, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Subjekti "Ujësjellës Kanalizime Delvinë" sh.a, duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin *"Infrastruktura Bashkiake IV", për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në qytetin e Delvinës*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Në vëmendje të veçantë gjatë monitorimit të jetë zona pranë Kalasë së Delvinës dhe Xhamisë së Xhermëhallës, nga Investitori dhe subjekti i licencuar pasi pritshmëria për gjetje arkeologjike është e lartë.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**

**ELVA MARGARITI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)